



DITARI JAVOR

15 - 21 Prill

VIZITA NË QARKUN VLORË

U nënshkrua marrëveshja midis Ministrisë së Drejtësisë dhe Bashkisë Vlorë, për zbatimin e masave alternative që do të shmangin nga ndjekja penale të miturit në konflikt me ligjin.

Në Universitetin "Ismail Qemali" Vlorë, për Paktin me Universitetin. Bashkë me kryetarin e Bashkisë Vlorë, z. Dritan Leli, Prefektin z. Mamaj dhe disa prej deputetëve të këtij Qarku, diskutuam me studentët e drejtësisë, në Fakultetin e Shkencave Humane

U zhvillua analizë pune me stafet e zyrave të këtij Qarku, të Shërbimit të Provës, Zyrës së Përmbartimit Shtetërorë dhe me IEVP Vlorë.

Fokusi në analizën me zyrën e Shërbimit të Provës u vendos tek zbatimi i Kodit i Drejtësisë Penale për të Miturit si një ndër objektivat kryesore të MD-së.

Gjatë analizës me punonjësit e Zyrave të Përmbartimit Vlorë, Sarandë dhe Fier, theksi u vendos tek cilësia, efektshmëria dhe profesionalizmi i shërbimit përmbartimor që ju ofrohet qytetarëve.

Në IEVP Vlorë, çështjet e sigurisë, lufta kundër korrupsionit si dhe rritja e cilësisë së trajtimit të të paraburgosurve, ishin çështjet kryesore të analizës së kryer.

TAKIM ME PËRFAQËSUES TË GRUPIT TË MIQËSISË FRANCË-SHQIPËRI

Me përfaqësues të grupit të miqësisë Francë-Shqipëri, të kryesuar nga Presidenti i Grupit, z. Rachel Mazuir. Qëllimi i kësaj vizite ishte njohja për zhvillimet e Reformës në Drejtësi, ngritja e institucioneve të reja të drejtësisë, mekanizmat e ngritura për luftën kundër korrupsionit dhe rezultatet konkrete që janë shënuar nga Task Forca Antikorrupsion. Z. Mazuir siguroi se Qeveria Franceze do të mbështesë Shqipërinë drejt rrugës në BE dhe nënvizoi se rezultate e arritura tregojnë se Shqipëria është në rrugën e duhur drejt së cilës duhet të vazhdojë të ecë.

KONTROLLI BAZË FALAS PËR ÇDO PERSON TË MOSHËS 35-70 VJEÇ QË VUAN DËNIMIN

Bashkë me ministren Manastirliu, në IEVP "Ali Demi" për realizimin e check up-it për gratë e dënuara dhe të paraburgosura. Check up-i për herë të parë, filloi me 20 gratë e këtij institucioni dhe do të vijojë për 2200 të dënuar dhe të paraburgosur në të gjithë IEVP-të e vendit të moshës 35 - 70 vjeç.

LEKSION I HAPUR NË AKADEMINË E SIGURISË

Leksion i hapur në Akademinë e Sigurisë, Fakulteti i Sigurisë dhe Hetimit. Ecuria e Reformës në Drejtësi, procesi vetingut si dhe lufta ndaj korrupsionit, ishin temat e leksionit.